



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 5353

Tirane, date 31.04/2015

Drejtuar: Z. SOKOL HAJDARMATAJ
SHOQERIA "LIRIDONI GROUP" SH.P.K
GODINA NJE KATESHE, PRANE SHKOLLES SE MESME,
FSHATI ZOGAJ,

TROPOJE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1475 date 04.06.2010.

I nderuar zoti Hajdarmataj,

Shoqëria "Liridoni Group" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1475 date 04.06.2010, për mineral kromi, objekti "Lugu i Gjinit", Zogaj, Tropoje, ne Qarkun Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2012 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.930 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1475 date 04.06.2010, për mineral kromi, Lugu i Gjinit, Zogaj, ne Qarkun Kukës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1475 datë 04.06.2010, për mineral kromi, objekti “Lugu i Gjinit”, Zogaj, Tropoje, në Qarkun Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1475 datë 04.06.2010.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

